

13 shtator 2012, Prizren

Njoftim nga takimi i kryetarit me drejtorët e komunës Qeveria lokale synon përmirësimin e arkëtimit të hyrave vetanake

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Transparenca online e komunës së Prizrenit" gjatë kësaj jave ka marrë pjesë në mbledhjen e radhës të kryetarit të komunës, Ramadan Muja me drejtorët komunal, ku janë miratuar një varg konkluzionesh. Për shkak se këto vendime kanë të bëjnë me interesin publik, EC Ma Ndryshe për hir të rritjes së transparencës së ekzekutivit lokal, tani e tutje do të publikoj njoftimet nga takimet e qeverisë komunale respektivisht vendimet e miratuara.

Ekzekutivi i komunës së Prizrenit në takimin e fundit ka miratuar konkluzionin e propozuar nga Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për lejimin e shpalljes së tenderit për realizimin e projektit për "hulumtimin mbi identifikimin e problemeve dhe mundësitë e përmirësimit të të hyrave vetanake të Komunës së Prizrenit". Qëllimi i projektit sipas zyrtarëve përgjegjës komunal është identifikimi i problemeve në arkëtimin e obligimeve të tatimit në pronë dhe të taksave komunale. Po ashtu është miratuar konkluzioni i propozuar nga DEF për shpalljen e tenderit për ofrimin e trajnimit të stafit, që ka të bëjë me përmirësimin e shërbimeve komunale (para-llogaria 9.950 €), sikurse edhe vendimi për pagesën e punëve dhe shërbimeve të veçanta për administratën komunale të Prizrenit (në shumë prej 20.000 €).

Qeveria komunale ka miratuar edhe propozimet e drejtorisë së Shërbimeve Publike për lejimin e shpalljes së tenderit për mbledhjen e fidanëve drunore dekorative në qytet (parallogaria rreth 10.000 €), pastaj për shpalljen e tenderit për rrethoja standarde të oazave të gjelbra, shesheve, lapidarëve, etj, nga pozicioni i projekteve kapitale (shuma prej 10.000 €). Ndërkaq është lejuar edhe shpallja e tenderit për ndërtimin e disa rrugëve lokale me pjesëmarrje të qytetarëve (rruga "Bujana" dhe "Lagja e Zekajve" në fshatin Korishë).

Bordi i Drejtorëve ka miratuar edhe propozimin e Drejtorisë së Administratës rreth lejimit të shpalljes së tenderit për furnizim me material për mirëmbajtjen e rrjetit elektrik, të ujësjellësit, dhe kanalizimit, sikurse edhe të sistemit të ngrohjes qendrore në objektin e komunës. Në këtë mbledhje janë miratuar edhe disa konkluzione të karakterit teknik, ndërkohë që është marrë vendim që të mbështeten aktivitetet me rastin e shënimit të 15 shtatorit – Ditës së Dëshmorëve dhe shtrimi i drekës tradicionale për familjarët e dëshmorëve.

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr. Ismet J. Kumanova 31 - Prizren
Rr. Zeki Shulemaja 2 - Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771

